Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e paguame

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО: ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ
DY HERE NE JAVE: T'EJ... DHE TE DIELLEN
Redakcija: Prishtine Rruga Emin Duraku Nr. 1
PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —
Dorshkrimet nuk kthehen
Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 134 | PRISHTINE, e djelle 8 Gusht 1948 | Çmimi 2 dinarë

Mbi ndertimin e ekonomikes socjaliste te RFPJ-es

Referat i shokut Boris Kidriç

Shoku Boris Kidriç paraqiti para Kongresit referatin „Mbi ndertimin e ekonomikes socjaliste te RFPJ-es". Delegatet e pershendeten me duertrokitje te vazhdueshme shokun Kidriç, po sa duel ne tribune.

Pjesen e pare te referatit te vet „Zhvillimi dhe kushtet e ndertimit t'ekonomikes socjaliste ne RFPJ-n nga çirimi e deri me sot", shoku Boris Kidriç e filloi me konstatacjonin qe vijon:

„Revolucjoni populluer jugosllav, pushteti popullor revolucjonar ne RFPJ-n, qe ka linde nga lufta çirimtare, t'udhehequn nga Partija Komuniste e Jugosllavis, kane muejte me marre vetem nji drejtim si ne pikpamjen ekonomike ashtu edhe n'ate shoqnore-drejtimin e ndertimit te socjalizmit n'Vendin t'one ne baze te shkences se marksizem-lenjinizmit. (Duertrokitje)

Çdo drejtim tjeter do te shkaktonte kthimin mbrapa, e çarjen dhe fitoren e kontrarevolucjonit dhe te mvaresis kombtare nga imperjalizmi likuidimin e pushtetit popullor dhe te fitoreve tjera demokratiko-popullore te luftes nacjonal-çlirimtare.

Hegemonia i revolucjonit popullor jugosllav-klasa puntore e Jugosllavis me Partin Komuniste te Jugosllavis ne krye-asht angazhue me nji here mbas çlirimit definitiv te Vendit t'one per ndertimin e ekonomikes socjaliste, tue qene kushjente se, ne ket menyre ne territorin e atdheut te vet, te çlirum me te vertet per heren e pare e ne çdo pikpamje dhe te rindertum, po e ploteson detyren themelore historike te levizjes puntore nderkombtare: likuidimin e çfrytezimit te njeriut prej njeriut. (Duertrokitje).

Shtresat ma te gjana punuese te Vendit t'one te bashkueme ne Frontin popullor, u kane dhane perkrahjen e vet masave fillestare ekonomike te karakterit socjalist, tue e pa nga keto rrugen e çlirimit te vet ekonomik e shoqnuer.

Mbi kushtet specifike dhe legjimitetet e pergjithshme te ndertimit t'ekononikes socjaliste ne RFPJ-n

Tue marre parasysh se revolucjoni i jone ka lind dhe asht zhvillue ne kushtet e luftes çlirimtare bashke me luften ma te gjane masovike, dhe se ndertimin e ekonomikes socjaliste e kemi fillue mbas 28 vjetve t'egzistences se Bashkimit te Madh Sovjetik, si vendi ma i madh socjalist ne bote, dhe kur jane kristalizue, gjithashtu si rezultat i luftes se dyte botnore, n'Europen lindore dhe te mesme, demokracit te reja popullore-rruget direkte dhe format direkte, te cilave iu kemi hy per ndertimin e ekonomikes socjaliste ne Vendin t'one, kane qene dhe domos do t'ishin specifike. Na asht dashtë me u kujdesue si per kushtet t'ona te mbrendshme ashtu edhe per kushtet e reja te zhvillimit botnuer. Sikur te mos kishim punue keshtu, do te kishim harrue „shpirtin e gjalle" te marksizem-lenjinizmit, djalektiken dhe do t'a kishim hjedhe poshte revolucjonin t'one. Na do t'ishim te ngjajshem me ato dokmatiket dhe mekaniket per te cilet Stalini thote: „Grupi i pare kufizohet, zakonisht, ne pohimin e jashtem te marksizmit, ne deklarimin e tij solemne. Mbasi nuk din ase nuk dishron me hye thelle ne mbrendin e marksizmit, mbasi nuk e din ase nuk don me e transformue ne jete, ai grup i kthen edhe hypotezat e gjalla e revolucjonare te marksizmit ne formula te vdekuna, qe s'thone kurrgja. Aktivitetin e vet nuk e bazon n'eksperience, ne rezultatet e punes praktike, por ne citate te Marksit..." (nenvizue nga B.K.).

Prandaj, rruget direkte dhe format direkte, me te cilat e kemi fillue me e ndertue ekonomiken socjaliste ne Vendin t'one, nuk kane muejte dhe as nuk kane gunue me qene te ngjajshme me ato te Rusis Sovjetike mbas Revolucjonit te Tetorit. Kjo, natyrisht, kurseni nuk do te thote se per ndertimin e ekonomikes socjaliste ke na nuk vlejne te njejtat legjimitete te pergjithshme te zbulueme dhe te perpunueme nga marksizem-lenjinizmi, nga shkenca gjenjale e Marksit, Engelsit, Lenjinit dhe Stalinit, te cilat kane vlefte ne Bashkimin Sovjetik. Kjo, mandej, kurseni nuk do te thote se ndertimi i ekonomikes socjaliste ne RFPJ mundet dhe guxon me u-ba, simbas permbajtjes se vet te pergjithshme, ndryshej nga ajo qe ka qene ne Bashkimin Sovjetik. Mirepo, kjo do te thote se rruget direkte dhe format direkte ke na guxojne dhe bile duhet doemos te kujdesohen si per kushtet t'ona specifike te mbrendeshme ashtu edhe per kushtet e pergjithshme te reja, qe jane rezultat i levizjes se panderpreme te historis, e ne mes te cilave bjen pa dyshim, ne rend te pare, ngritja e fuqive dhe influences te kampit botnuer te socjalizmit, me Bashkimin Sovjetik ne krye, ngritja e madhe ne krahasim me situaten e Tetorit te vjetit 1917 dhe te luftes civile prej vjetit 1918 deri ne vjetin 1920.

Me lejoni, shoke, qe te merrem disi ma konkretisht me disa kushte ma kryesore, specifike, d.m.th. kushte te reja historike, te cilat kane ndikue per gjidhjen e formave t'ona ne fillim te ndertimit t'ekonomikes socjaliste ne Vendin t'one.

Kushti kefille i pare specifik padyshim asht fakti se revolucjoni i jone asht zhvillue ne bazen dhe ne kuadrin e luftes Patriotike kundra pushtuesave fashist, ne bazen dhe ne kuadrin e luftes s'armatosun kundra tradhtis kombtare nga ana e borgjezis reakcionare si dhe kundra ndihmes qe i kane dhane kesaj ne tradhti qarqet imperjaliste te prendimit.

Ne fillim te ndertimit t'ekonomikes socjaliste ky kusht specifik u-çfaq ma se kjarti ne faktin se çfaqja e pare e tipit socjalist t'ekonomis s'one nuk duel si perfundim i nacjonalizimit formal, por nga konfiskimi i pasunis se tradhtarve te popullit.

Kushti i dyte specifik, i lidhun me te parin, perbahet nga fakti se rruga e revolucjonit t'one jo vetem se e ka lejue, por edhe e ka kerkue dhe e ka mbrrijte bashkimin e pazgjidhshem me katundarin e mesem, me gjithe çfaqjen e lekundshmenis se tij, kurse ne revolucjonin rus, gja'e kohes se rexinit te borgjezis nga fuqija, asht lekund dhe ka kundershtue ma se shumti bash katundari i mesem, çka n'ate kohe ka kerkue politiken e aleances me katundarin e vorfen dhe neutralizimin e katundarit te mesem.

Kushti i' trete specifik, i lidhun me te dy te paret, perbahen nga fakti se ke na, mbas çlirimit, nuk asht ba lufte civile dhe as intervencjon i armatosun i imperjalistave, porse kemi muejte me fillue me njihere me rindertimin e plote te formave punuese, te bashkueme ne Frontin popullor, nen udheheqjen e PKJ-es, o'ensiven e gjane te gjithaneshme per rindertim, e bile edhe per rekonstruimin teknik t'ekonomis s'one. Ky kusht na ka dhane mundesi, njikohsisht, qe me nji here t'ia fillojme dhe t'a forcojme pa nderpre n'esence o'ensiven socjaliste per zgjanimin dhe ndertimin e sektorit ekonomik shtetnuer dhe kooperativist.

Kushti i ri historik per ndertimin e ekonomikes s'one socjaliste çfaqet ne faktin se, nga fitorja e madhe e Bashkimi Sovjetik mbi fashizmin gjerman dhe tendencen e tij mbi hegemonin botnore, si dhe nga krijimi i demokracive te reja popullore, qe u-ba ne saje te fitores se Bashkimit Sovjetik revolucjoni i jone nuk ka muejte me qene i rrethuem ne rrethin kapitalist, n'ate mase kercnimi siç ka qene i rrethuem Revolucjoni i Tetorit. Revolucjoni i jone, natyrisht, u-perlesh menjihere me rrethin kapitalist dhe perleshet, por per vet fillimin e ndertimit t'ekonomikes s'one socjaliste, ka qene e randesishme qe kemi muejte me marre me nji here lande te para dhe karburanta nga Bashkimi Sovjetik per vuemjen ne levizje t'industris s'one, se kemi muejte me fillue shum shpejte me vendosjen e marredhanjeve ekonomike me demokracit popullore dhe vendet tjera dhe se, tue i marre parasyshe koalicjonin Sovjeto-Anglo-Amerikan ne luften patriotike, tue marre parasyshe influencen nderkombtare kolosale, reale dhe morale te Bashkimit Sovjetik si dhe tue marre parasyshe influencen me shum randesi moralo-politike te vet Jugosllavis-kemi marre nji ndihme ma te ndieshme te UNRRS-it ne materjal konsumi ashtu dhe ne lande te pare dhe makina.

Derisa Revolucjonin e Tetorit e pasoi intervencjoni dhe rrethimi kapitalist, na, perkundrazi, kemi muejt me fillue rindertimin e ekonomis s'one, tue e fokusuadrue sektorin e rikrijimin te tipit socjalist, me vendosjen e menjihereshme te marredhanjeve ekonomike me vendet e tjera. Nen kushtet e mbarimit fitimtare te luftes patriotike, qarqet imperjaliste te prendimit jo vetem qe nuk kane qene te afte me organizue rrethimin e demokracis reale te jones popullore, por, gjithashtu, nuk kane muejte me pengue dhanjen e ndihmes ma elementare nderkombtare te mbasluftes, vendeve te damtueme nga lufta, ne mes te cilave vjen edhe Jugosllavija e re revolucjonare.

Qe, keto jane kushtet ma elementare specifike, d.m.th. kushtet e reja historike, ne te cilat kemi fillue me e ndertue ekonomiken t'one socjaliste. Natyrisht kelyne kushteve doemos u asht dashte te reflektohen si ne rrithmin ashtu edhe ne format e ndertimit t'one. Ne krahasim me vjetet e pare, bile ne dhetvjetshin e pare mbas Revolucjonit te Tetorit deri ke "vjeti i transformimit te madh-1929", ata na e kane lehtesue punen, na kane lejue nji rrithem ma te shpejte, e bile edhe disa forma ma te gjana.

Ket punë e ilustrojne ma se kjarti shifrat. Ne Bashkimin Sovjetik, perludha e rindertimit ka muejte me u-krye ne vjetin e nande mbas Revolucjonit te Tetorit, ke na asht krye, persa i perket prodhimit, ne vjetin e dyte mbas çlirimit definitiv. (Duertrokitje frenetike). Ne Bashkimin Sovjetik sektori socjalist ka perfshi, ne vjetin 1924 deri ne vjetin 1925,-81% te industris, e sektori privat 19%, sektori socjalist i tregtis 58% e ai privat 42%, sektori socjalist i tregtis me shumice 91% e ai privat 9%. Ne vjetin 1926 deri ne vjetin 1927 sektori socjalist ne Bashkimin Sovjetik, ka perfshi 86% t'industris e sektori privat 14%, ne tregti-sektori socjalist 68% e ai privat 32%, ne tregtin me shumice-sektori socjalist 95% e ai privat 5%. Ke na, ne vjetin e pare mbas çlirimit, kane qene ne duert e shtetit 55% te gjithe industris, e 27% kane qene nen sekuestrimin shtetnuer, çka praktikisht e ne çdo pikepamje do te thoshte te njajten gja sikurse nacjonalizimi. Ne mbarim te vjetit te dyte mbas çlirimit sektori shtetnuer ka perfshi te tane industrin me karakter federalle dhe republikan e 70% t'industris lokale. Mandej, ne sektorin shtetnuer gjindej i gjithe veprimi bankar, e gjithe tregtija me shumice, komunikacjoni, te gjitha mjetet per lidhje dhe 90% te tregtis me pakice. Tregtija e jashtme asht ne tanesi monopol shtetetnuer. Ne vjetin 1948, e gjitha industrija, e gjithe tregtija me shumice i gjithe veprimi bankar dhe pjesa dermuese e tregtis me pakice, gjinden ne sektorin socjalist, e teprica e tregtis private me pakice asht ne likuidim e siper.

Bashkimi Sovjetik e aprovon Planin e vet te pare ne vjetin e njimbdhet mbas Revolucjonit te Tetorit, kurse RFPJ-a ka muejte me e aprovue qysh ne fillim te vjetit te trete mbas çlirimit.

Theksova se kushtet specifike dhe kushtet e reja historike na e kane lehtesue punen, porse, ato, natyrisht, nuk perfaqsojne ndonji „medo" t'onen (kete te fundit nuk do t'a permendsha sikur shumë njerez te mos i kercnohej rrezikue ket fushate te zeze kundra Partis s'one qe fjalve te tije u jepet nji kuptim tjeter.) Perkundrazi, pikerisht ato, te cilet, ne themelin e eksperiences s'one e kemi ndie, ne praktike e jo vetem nga librat, se shka don me thane me luftue kundra nji morije veshtiresish ne nji vend te shkatrruem nga lufta dhe te mbrapambetun teknikisht-pikrisht ne trupnat t'one jeton ai admirimi i vertete i sinqerte per perpjekjet vigane dhe rezultatet e Partis te Lenjinit e Stalinit dhe te popullit sovjetik, te cilet-me gjithe veshtiresit, deri „ne vjetin e transformimit te madh", fare te pakrahasueshme me çfardo perpjekjeje tjeter revolucjonare te kalueme dhe t'ardhshme, per hir veshtiresive, çfare mund te çfaqen vetem nji here ne histori, sepse ata shkon perpara-me nji fryme te pathyeshme kane krijue epoken e re te njerzimit dhe keshtu iu kane ba te mundshem vendeve te tjera kushte te reja, te lehta... (Duertrokitje frenetike).

Derisa kushte te reja dhe „rrethana lehtesuese" mbi te cilat fola, nuk jane, natyrisht merite e jona-asht merite e Partis s'one, qe ajo ka dijte me e çmue drejte, me nxjerre nga çmimi i drejte konkluza te drejta praktike dhe me gjete format perkatese, ne menyre qe t'i shpejtoje sa ma teper zhvillimin ekonomik dhe ndertimin socjalist te Vendit t'one. (Duertrokitje).

Mirepo, ke e nuk e kane kuptue gjithmone dhe plotesisht te gjithe ata qe kane pase pozita udheheqse ne Partin t'one dhe n'aparatin t'one shtetnuer. Ka pase tentativa qe rruget direkte dhe format direkte te vjetve te pare mbas Revolucjonit te Tetorit, te tranzmetohen mekanikisht ne terenin t'one pa ndonji analize te gjithanshme te permbajtjes se tyne, pa analize konstruktive te kushteve t'ona te mbrendshme, pa analize dijalektike te kushteve te reja te pergjithshme.

Dihet se nji mekanizem i ketille se nji kundershtim i ketille i dijalektikes markiste e ka pase burimin e vet kryesuer ke Hebrangu dhe Zhujoviqi.

Un ketu nuk do te hyej ne punen e tyne te damshme direkte n'ekonomin t'one. Ma vone do te flas se si kane tentue me e pengue ndertimin socjalist ne Vendin t'one me „teori", te ndryshme „te perpunueme".

Tash do t'i ceki dy-tri momente theorike te cilat, edhe disa kuadra t'ona te ndershme, ma se shumti nen influencen e Hebrangut e Zhujoviqit, i kane kuptue shtrembet, mbasi eksperiencen sovjetike e kane transmetue mekanikisht e jo ne menyre djalektike.

Dihet se ke na kane shkaktue çregullim gjate nji kohe mjaft te madhe hamendje te ndryshme se a do te zhvillohemi apo jo drejte kapitalizmit shtetnuer.

Mirepo, „teoricjenet" e kapitalizmit shtetnuer ne Jugosllavi kane harrue se Lenjini ka pase parasyshe, para se gjithash, koncesjonet kur e analizonte kapitalizmin shtetnuer."... Kuptohet vetiu se na duhet me vue koncesjone ne disposicjon te borgjezis se huej, te kapitalit te huej. Pa decentralizimin ma te vogel, na iu dorezojne kapitalistave te huej minjera, pyjet, burimet e naftes, per te muejte me marre nga ato prodhime industriale, makina, etj. dhe, ne ket menyre me e rindertue industrin t'one..."). thote Lenjini (V.I. Lenjin, Soçinenija, tom. XXVI, faqe 300). Na jo vetem qe nuk kemi pase nevoje te randesishme per kon-

(Vazhdon ne faqen e dyte)

Vazhdim i referatit te shokut Boris Kidriç

(Vijon nga faqja e pare)

çesjonet as kapitalistave te huej as te mbrendshem, por, tue marre parasysh kushtet t'ona te rindertimit te shpejte, ka qene krejtkpat ndryshej. E kemi marre rrugen e konfiskimit dhe sekvestrimit lit'e para se rrugen e nacjonalizimit. Ne realitet kjo do te thohte-mbasi zekuistrimi jo vetem qe e ka vue industrin nen drejtimin ekskluziv shtetnuer, por rregullisht e ka marre edhe te tane akumulimin-pikrisht drejtimin e kundert nga drejtimi i koncesjoneve, nga drejtimi i perdorimit te kapitalizmit shtetnuer. Kjo, n'esence, ka qene, ende para nacjonalizimit formal, drejtim i sulmeve dhe shkurmjes perpara-tue marre ne pergjithesi-n'orientimin socjaliste n'ekonomin t'one.

Prandaj, me fole mbi zhvillimin e RFPJ-es ne drejtim te kapitalizmit shtetnuer do te thohte-me e shtye Vendin t'one ne koncesjone, me vend qe me e pergatite, organizue dhe zhvillue ofensiven socjaliste me anen e lufjes se perkoheshme dhe te kufizimit t'atyne pozitjoneve ekonomike privato-kapitaliste, per te cilat nuk jane pjeke ende kushtet qe t'i likuidojme. Tranzmetimi mekanik ne kohen e vet dhe ne vendin e vet, po te formave te drejta asht kthye, pra ne kushtet t'ona ne nji qendrim thjeshte oportunist. Mekanicet dhe oportunistat kane zhvillue kurr mbi kapitalizmin shtetnuer, e keshtu ne konsegumcen e fundit edhe mbi koncesjone, pikrisht atehere kur Vendi i jone çlirohej, me konfiskime dhe sekuestrime, nga tendenca e kapitalit te huej financjar!

„Teoricjenet" e kapitalizmit shtetnuer ne RFPJ i kane perdorue, mandej, sipermarrjet thjeshte shtetnore -si kapitalisto-shtetnore e me kete rasme gjithe mbeshtetjen e tyne ne shembullin sovjetik dhe ne formen sovjetike i kane harrue fjalet e Stalinit: „Te marrim tipin e dyte te sipermarrjeve-sipermarrjeve shtetnore. A thue jane nto shtetnore kapitaliste? Jo, nu kjane. Pse? Per shkak se ne to nuk jane dy klasa por nji, klasa e punetorve, e cila ne drimen e shtetit te vet i zotnon veglat dhe mjetet e prodhimit, dhe e cila nuk asht e çfrytezueme, sepse maksimumi qe nxirret nga sipermarrja mbi meditjen, shkon per zgjanimin e matejshem te prodhimit, d.m.th. per permirsimin e pozites se mbare klases puntore ne tanesi.

Mund te them se ky prap nuk asht socjalizem i plote, po t'i kemi parasysh ato mbeturina te byrokratizmit qe jane ruejte n'organet udheheqese te sipermarrjeve t'ona. Kjo asht e drejte. Por kjo nuk bjen ne kundershtim me faktin se industrija shtetnore asht prodhim socjalist simbas tipit te vet (Stalin, fjalim i mbajtun ne Kongresin e XIV te PK (b) te BRSS, me 1925, veprat, volumi VII-te, faqe 304—307)."

Mirepo, KQ i Partis s'one e ka cmue drejte se format shtetnoro-kapitaliste nuk kane, ne kushtet t'ona te rindertimit ekonomik, kurrfare randesije ma te madhe, e prandaj i'ka hjedhe ploteisht poshte qysh ne vjetin 1945 e, njikohesisht, me rindertimin ka marre rrugen gjithnji ma kjarte dhe te caktueme, ne nji ane, ne ndertimin e industris thjeshte shtetnore te tipit socjalist, e ne anen tjeter, per pregatitjen e nji ofensive gjithnji ma te gjane kundra pozitave kapitaliste.

Shembulli tjeter i ngjajshem ka qene komandja mekanikiste se si me e zbatue ke na NEP-in (politiken e re ekonomike), me se ajo egziston apo jo etj. Mekanikistat kane harrue me ket rast se lindja konkrete e NEP-it ne BRSS ka qene e kondicjonueme historikisht me rrethanat, te cilat „Kursi i shkurte i historis se PK (b) te BRSS, i pershkruen keshtu: „komunizmi luftarak ka qene tentative qe fortesa e elementave kapitalist ne katund e qytet te merret me sulm, me mesymje frontale. Ne kete ofensive, Partija ka shkue shum perpara tue u ekspozue rrezikut me humbe lidhjen me bazen e vet. Tash Lenjini ka propozue qe te shkohet pak mbas, qe perkohesisht te terhiqemi diçka ma afer mbrapavijes, qe nga sulmet te kalohet ne rrethimet ma te gjata te fortesas, qe menyre qe mbasi se grumbullohen forcat, te filloje perseri ofensiva".

Komunizmi i ketille luftarak, siç ka qene perpara ne BRSS, ke na nuk ka ekzistue fare. Masat ekonomiko-luftarake, qe i kemi zbatue, jane zbatue ne kushte dhe ne vijen e luftes patriotike e jo ne kushtet dhe ne vijen e luftes civile mbas Revolucjonit te Tetorit, siç ka qene ne BRSS. Ne luften t'one çlirimtare kundra okupatorit dhe ne zhvillimin e mbas-luftes jane ba ndryshime ma te thella, revolucjonare politike dhe shoqnore; ne lufte kundra kapitalizmit dhe te trathtis kombtare te borgjezis reakcjonare proletarjati asht ba hegemon i revolucjonit populluer, asht mposhte pushteti i borgjezis; qysh ne kohen e luftes masat t'ona ekonomike kane, ne substancen e tyne, karakter socjalist mbasi proletarjati asht hegemon i luftes çlirimtare; masat e atilla te luftes siç kemi zbatue na, borgjezija nuk do te donte as nuk do te guxonte, me i zbatue edhe ne qofte se do te banite lufte; por ato ne fazat e para te luftes, nuk i kane ndrrue marredhanjet e pergjithshme ne prodhim, ne nji vllim ma te madh ne pikat komanduese ekonomike. Masat e ketilla kane dale vetem kah fundi i luftes dhe mbas mbarimit te saje, mbas çlirimit definitiv, ne periudhen e rindertimit dhe te zhvillimit te matejshem te revolucjonit. Tue i marre parasyshe te gjitha keto, rrethanat e ketilla konkrete per terheqjen nga kthyemja prej komunizmit luftarak drejt NEP-it, siç kane qene ne BRSS, ke na nuk kane egzistue fare dhe as nuk kane mujte me egzistue. Sikur Partija e jone, ne periudhen e rindertimit, d.m.th. tue marre parasysh kushtet t'ona, te shkurmjes perparate kish fejue tranzmetimin mekanik t'eksperiencave te NEP-it, nga periudha e saje e pare, do te muejshim me ra vetem ne nji gabim te ngjajshem ase bile „edhe ma te rande per nji grade", ne te cilin kane pase ra trockistat dhe opozicjonetet etj.' te cilet kane mendue se NEP-i asht vetem terheqje. Ke na ne kushtet t'ona jo vetem se ka rase, gjithashtu, berje perpara, por ka mujte dhe ka ... me qene-tue e marrun ne pergjithesi vetem berje perpara qe prej vet fillimit.

N'anen tjeter mekanikistat, bash per shkak te mekanizmit dhe oportunizmit te tyne kane harrue ato legjitimitete te pergjithshme dhe eksperienca te pergjithshme sovjetike te NEP-it, ase te periudhes tranzitore prej kapitalizmit drejte socjalizmit, te cilat ke na vlejne gjithashtu deri ne ndertimin e socjalizmit; legjitimitetet e pergjithshme dhe eksperiencat e pergjithshme sovjetike t'ofensives se sektorit socjalist me egzistimin e dy sektoreve te lufte reciproke-sektorit socjalist e privat, kapitalist.

Shembullin e trete te moskuptimit te vrashte mekanik, jodjalektik e kane dhane armiqet e mbrendshem te Partis s'one me paralajmrimet e veta shpirte-zeza se na nuk e kemi krye nacjonalizimin e tokes, dhe se „siç shihet, politika e jone ndaj katundarit nuk asht diçka ne rregull". Ne fushaten e tashme kundra Partis s'one jane çfaqe disa „kritikues" nga radhet e Partive tjera Komuniste, me te njajtat, " theza", por te formulueme ma shpesh, te cilet pohojne se ke na jo vetem qe nuk ka ndertim socjalist, por se nuk e kemi krye as revolucjonin borgjezo-demokratik, mbasi nuk e kemi zbatue nacjonalizimin e tokes. Po e permendi se ket mekat nuk po na e mveshin ende partit komuniste te demokracive popullore, por ato e Frances dhe Italis.

Ku qendron, pra, çeshtja?

"Kritikuesat" kane lexue padyshim se nacionalizimi i tokes ne realitet nuk asht mase e revolucjonit socjalist, por e atij borgjezo-demokratik, mbasi ketu asht ne mes renta nga toka dhe mbasi pronari i tokes si i ketille asht figure krejte e panevojshme per menyren e prodhimit kapitalist.

Po, ashtu asht!

Mandej "kritikuesat", kane lexue se dekreti mbi nacjonalizimin e tokes ka qene nji nga dekretet e para te Revolucjonit te Tetorit.

Edhe kjo asht e vertete!

Kur e gjith kjo asht e vertete, kur egziston nji prove kaq e kjarte-padyshim „perfundon" „kritikuesi" i shpejte, sikur se asht deshira me e sulmue Partin t'one-asht krejtesisht e kjarte se jugosllavet nuk ndertojne boshik kurrfare socjalizmi, mbasi nuk e kane zbatue nacjonalizimin e tokes, qe d.m.th, nji mase e revolucjonit borgjezo-demokratik, e njikohesisht - si gruabte kundra prones private i pergjigjet proletarjatit dhe e cila asht shpalle menjihere ne Rusin sovjetike mbas Revolucjonit te tetorit, para nacjonalizimit te industris se rande etj.

Sikurse te lexnte vetem logjika formale, ndoshta se fundi edhe do te kishin te drejte „kritikuesat" t'one. Mirepo, fatekeqsija e tyne qendron ne faktin se vlene bash dialektika, prap-kushtet historike dhe format relative, rruget perkatese. (duerbolike frenetike).

Ne lidhje me çeshtjen e nacjonalizimit te tokes nen kapitalizmin, Karl Marksi-mbasi ka konstatue se pronari i tokes si i tille asht i panevojshem per menyren e prodhimit kapitalist, e cila do te mundte me funksjonue edhe ne kushtet kur toka t'i takoje shtetit-thote: „Prandaj, borgjezi radikal bjen teorikisht ne mohimin e pronesis private mbi token.... Njikohesisht e humbe kurajon ne praktike, mbasi sulmi mbi nji forme te pronesis, formen e pronesis private mbi kushtet e punes, do t'ishte shum i rrezikshem edhe per format tjera. Perveç kesaj borgjezi e ka territorjalizue veivehten" (nenvi ne B.K.). (Karl Marks, theorit mbi teprricen e vleftenave). Per ne momentalisht asht e randesishme fjala- "territorjalizue". Çka don me thane kjo? Lenjini thote:„Marksi ka parasysh, kjartasi se bash menyra borgjeze e prodhimit asht perforcue ne pronesin private mbi token, d.m.th., se kjo prone private asht ba shum ma teper se sa feudale. Kur, borgjezija, si klase, ne nji vllim te gjane sundimi, asht lidhe me pronesin e tokes, tashma „veivehten e ka territorjalizue", „ka vue dore mbi token, e ka nenshtrue plotesisht pronesin mbi token- athere nuk mund te kete ma levizje te pergjitheshme te vertete borgjeze ne dobi te nacionalizimit. Kjo nuk mund te mbahet nga mnyeja e thjeshte se asnji klase nuk do te shkoje kundra veivehtes". (Lenjin, Soçinenija, tom XI f. 413).

Pra, puna deri tash asht e kjarte.

Por, Lenjini mandej thote: „ke na ne Rusi egziston „borgjezi radikal" i atille, i cili nuk asht „territorjalizue" ende, i cili nuk mund te theksohet ne momentin aktual nga „sulmi" proletar. Ky „borgjez radikal" asht-katundari rus". (Ibidem 414).

Te gjitha keto qe i cituem deri tash, i ka shkrue Lenjini ne vjetin 1907. Ne vjetin 1917 Lenjini thote: „ne realitet katundaret kane ardhe ne konkluzion, se e tane prona toksore ruse, katundare dhe pronare, e perbashket dhe individuale, asht e mbushun plot me kushtet e regjimit te vjeter gjysem-feudal, dhe katundaret asht dashte te kerkojne, nga pikpamja e kushteve te tregut, kalimin e tokes ne due t e popullit. Katundaret pohojne se pozita e ngatrrueme e jetes se marredhanjeve agrare mund te zgjidhet vetem me anen e nacjonalizimit. Pikepamja e ketyne asht borgjeze-çfrytezimin e barabarte te tokes ata e kuptojne si marrjen e tokes nga pronaret - ... hijte, e jo si barazim per çdo pronar. Nacjonalizimi do te thote-me vue token ne dispozicjon te gjalle sipas mundit te frymeve. Ky asht projekti ma i madh borgjez. Asnji katundar nuk ka fole mbi barazimin dhe socjalizmin, por te gjithe kane fole se nuk mund te pritet ma gjate, se duhet te ndahet e gjithe toka d.m.th. se ne shekullin e njizet nuk mund t'udheheqet ekonomija shtepijake ne menyre te vjeter. Kurrefare formash te ndryshme te pronesis mbi token nuk ... te jene. Ketu bile nuk ka kurrfare socjalizmi. Kjo kerkese e katundarve duhet barazuese per shkak se, siç e tregon rezultati i shkurte i statistikes se prones tokesore nga vjeti 1905, ne 300 familje katundare dhe nji familje pronare vijne 2.000 dhetshe toke; natyrisht ne kete drejtim ajo asht ba, razue, por nga kjo nuk del se ne kete menyre duhet barazimi i te gjithe pronave te vogla. Projekti 104-tregon te kunderten". (Lenjin, Soçinenija, tom XX, f. 299)

Çka del nga kjo? Nga kjo del:

a) katundari ne Rusi jo vetem e ka pranue, por e ka propozue nacjonalizimin e tokes;

b) se e ka pranue kete mase socjaliste, por si mase borgjezo-demokratike, mbasi nuk ka gucue me pase „kurrfare formash te ndryshme te pronesis mbi toke";

c) se katundari rus, jo vetem deri ne vjetin 1907 por dhe as deri ne vjetin 1917, nuk ka qene „territorjalizue" ende, mbasi gjithashtu nuk do t'a pranonte nacjonalizimin e tokes.

Per ne kjo e dyta asht esenciale. Zhvillimi historik ne territorin e RFPJ-es se tashme, ka shkue, ne realitet, nji rruges krejt tjeter. Territorjalizmi i borgjezis ka fillue ne disa vise te Jugosllavis se tashme, p.sh. ne Slovenj dhe disa pjese te Kroacis, qysh para 150 vjetve. E çka do te thonte territorjalizmi i borgjezis? Ay pa dyshim e ka shoqnue sulmin e pergjithshem te kapitalizmit ne katund. E sulmi i pergjitheshem i kapitalizmit ne katund do te thonte jo vetem shkatrrimin e patriakalitetit por edhe likujdimin gradual te marredhanjeve gjysem- feudale dhe feudale dhe ndrrimin e tyne gradual e te vazhdueshem me format e reja te çfrytzimit kapitalist. Me kete rast nuk ka marre pjese vetem borgjezi ne pergjithesi dhe veçnas borgjezi i, „territorjalizuem", por edhe feudali i „kapitalizuem", te cilit, per shembull, mbas revolucjonit te vjetit 1848 ne pjesen e madhe te territorit t'ish Austro-ungaris, i asht dashte me pranue qe t'i hapen dyret kap e krah zhvillimit plotesisht te lire te sistemit kapitalist-vertete jo nen pushtetin revolucjonar, por nen pushtetin reakcjonar te kna ... borgjezo-monarko -feudal. Proçeset e njajta te ngjajshme kane ngja para ase mbas edhe ne pjeset tjera te RFPJ-es se sotshme, mbas c'ardo kushtesh qo'shin historiko-politike.

S'ka dyshim se katundari ke na, gjate ketyne proceseve, te cilet kane vazhdue ne disa rejone te Jugosllavis se sotshme deri ne 150 vjete, asht "territorjalizue" forte. Pjesa e ... kategorive t'ekonomive bujqsore ne mbare fondin toksuer te Jugosllavis se vjeter e tregon kete ma se miri. I tane fondi perbahej prej 10.615.980 hektare pa kullota. Nga ky fond, ekonominat deri ne dy hektare kane posedue 693.542 hektare ase 6, 5%, ekonominat prej 2 deri 5 hektare— 2.287.570 hektare ase 21, 5%; ekonominat prej 5-10 hektare: 2.873.155 hektare ase 27, 0%, ekonominat prej 10-20 hektare: 2.380.826 hektare ase 22, 3%, ekonominat prej 20-50 hektare: 1.388.570 hektare ase 13%, ekonominat prej 50-100 hektare: 338.076 hektare ase 3, 2%, ekonominat prej 100-200 hektare: 147.868 ase 1, 3%, ekonominat prej 200-500 hektare: 146.549 ase 1, 3%, ekonominat mbi 500 hektare: 389.824 ase 3, 7%. Ma teper se 50% te tokes i ka takue pronarit te vorfen dhe te mesem nen 10 hektare, mandej vjen kategorija e katundarve te mesem, diçka ma te forte, mandej e pasanikve te katundit nen 30 hektare, e 1.191.000 hektare ase 10% u takon pronarve mbi 30 hektare. Nga kjo, borgjezija e "territorjalizueme" e katundit dhe e qytetit ka posedue afer 90%, e feudalet (pa kishat) afer 10%. Prandaj, procesi i "territorjalizimit" i ka zbrite format e ndryshme te pronesis feudale mbi toke ne 1% te mbare fondit toksuer (pa pyje).

E çka don me thane kjo? Kjo don me thane se katundari i vorfen dhe i mesem ke na nuk asht vetem prodhues i mallit, por edhe pronar i tokes, pronar i kushteve te punes, d.m.th. i tokes. S'ka kurrfare dyshimi se kjo asht reflektue edhe ne psikologjin e tij. Per psikologjin e prodhuesit t'one t'imt mallnash katundarit, asht karakteristik edhe fakti se ai asht edhe pronare i mjeteve te punes, se ai asht bujk dhe pikrisht kjo karakteristike asht zhvillue ne psikologjin e tij gjate shum vjetve me radhe dhe bile gjate te tane shekullit te sulmit kapitalist ne katund. Pse? Per shkak se sulmi kapitalist, i cili e ka likujdue pronen feudale mbi toke, ma se pari e ka mjerre nga toka, sepse i asht dashte ... rezerve industrijale, e katundari i asht mprojte nga kjo, per arsye se kalu e maksimalizue e kapitalit financjar ne Jugosllavin e vjeter don me thane grabitje e te ershme e katundarit nga ana e borgjezis, e katundari e ka kundershtue me grabitje ma e shtue punen rreth tokes. Kjo e lidhe edhe ma teper per pronen e tij, e cila ne realitet po i humbe vazhdimisht, prej se cilës, ne realitet, e çfrytzon borgjezi vazhdimisht por i cili, me rezistencen e tij kundra borgjezis grabitçare, kundra bankave, kundra shfrytzuesve dhe çfrytzuesve te çdo lloji, kona nji rast edhe ma te forte psikologjik. Nuk duhet me e harrue as faktin se nen kushtet e krizes agrare te rende, borgjezija grabitçare financjaro-kapitaliste nuk ka si me ma aq per "territorjalizimin" e vet te ma tejshem se sa me mjerre sa ma shum nga katundari-pronari i tokes. Kjo e tregon edhe menyren e "zhgarkimit te katundarve" ne Jugosllavin e vjeter. Keshtu me kete rritet ke katundari punues mendija revolucjonare kundra kapitalit financjar ne fund, e bashke me çeshtjen nacjonale te pazgjidhun dhe t'ashpersueme. Katundari punues po hidhet ne praktike, gjithnji ma teper dhe nen udheheqjen e PKJ, ma i afert, aleat ma revolucjonar i klases puntore, por ky nuk i humbe nga psikologjija e vete karakteristikat e pronarit te tokes. Perkundra i ne me te parolave, ne baze te cilave PKJ e mobilizon katundarin punues n'aksjon kundra kapitalit financjar dhe borgjezis ne pergjithesi vjen edhe mprojtja e tokes se tij prej shpronsimit nga ana e grabitçareve kapitalista.

Prandaj, per sa i perket formes se prones mbi toke, psikologjija dhe pikpamja e katundarit jugosllav jane ndryshej nga psikologjija dhe pikpamjet e katundarit rus te vjetit 1917. Edhe katundari rus i vjetit 1917 si dhe katundari jugosllav i vjetit 1945 jane prodhues t'imt mallnash. Por, deri sa i pari asht, para lufte, "arendator", tjetri posedon toke, e posedon nen rrezikun e perhershem per t'a humbe, i grabitun, i çfrytzuem, i futun ne borçhe, i renduem me hipoteka shpesh here ma te medhaja nga vlefta e tokes se tij, por-si e posedon dhe e mprone, e kjo domosdo reflektohet ne psikologjin e tij.

Gabimi kryesor antidialektik i "kritikuesve" t'one qindron bash ne faktin se ata nuk e kane kuptue diferencen ne mes te Rusis sovjetike te vjetit 1917 dhe ne mes t'one ne vjetin 1945-1946 persa i perket formes se prones mbi toke dhe psikologjive perkatese te katundarve. Tue mos e kuptue se ke na katundari asht "territorjalizue", ata flasin kot per nacjonalizimin e tokes, si mase borgjezo-demokratike. "Forma definitive e pronesis mbi token", do te formulohet, due me thane, ne mbarim te periudhes transitore prej kapitalizmit ne komunizem.

Zbatimi i nacjonalizmit te tokes, si mase e revolucjonit borgjezo-demokratik ose "parakusht" per krijimin e procesit te rekonstruimit socjalist te ngjeshe do te thonte katastrofe per revolucjonin popullore te Jugosllavis. Ai ke na do te shkatrronte bashkimin e popullit punues, do te bante nga katundaret e vorfen dhe te mesem rrezerven aktive te borgjezis dhe te pozicjoneve te saja kapitaliste. Katundari nuk do t'a kuptonte kete si nacjonalizim toke borgjezo-demokratik, por si shpronsim te pergjithshem te prodhuesve t'imt mallnash. E mire do te dukej ajo ofensive "socjaliste", e cila nen kushtet t'ona do te fillonte me shpronsimin e katundarit te mesem dhe te vorfen ne vend te sulmit ne pozitat kryesore dhe ... katundarese ekonomike kapitaliste!

Prandaj, qendrimi i "kritikuesve" t'one, e thirrel Partin t'one per, nji ndermarrje avanturiste ndaj katundarit te mesem dhe te vorfen. Natyrisht, Partija e jone nuk ka shkue dhe as nuk do t'a ndjeke kete rruge.

Mirepo, asht padyshim se diferenca e shqyrtueme ma naile ne psikologjin

(Vazhdon ne faqen e trete)

Vazhdim i referatit te shokut Boris Kidriç

(Vijon nga faqja e dyte)

e katundarit t'one dhe katundarit rus dmth me thane edhe kete gja, se klasa e jone puntore nuk e ka pase ne luften e vete ate rezerve, te cilen per klasen puntore ruse e ka perfaqsue aerlesa katundare per nacjonalizimin e tokes. Por, a thue per kete arsye, mos asht katundari i jone punues ma pak i afte per t'u ba aleat i klases puntore, per t'u ba shok i saj luftarak ne luften per nji jete ma te mire, se sa ka qene katundari rus?

Padyshim, nuk asht.

Ne rend te pare duhet me e analizue vendin e katundarit te mesem dhe te vorfen n'ekonomi, ne menyren e prodhimit, ne marredhanjet e prodhimit. Stalini thote: "Ekonomija katundare nuk asht ekonomi kapitaliste. Ekonomija katundare, ne qofte se e marrim pjesen ma te madhe t'ekonomive katundare, asht ekonomi e imte mallnash". (çashtje te Lenjinizmit, faqe 155).

Per mundesit e zhvillimit t'ekonomis katundare, per drejtimin e zhvillimit te saje toka nuk asht gja vendimtare me gjithe se asht me randesi. Marksi i dallon ne "Kapitalin" e tij dy kategori mjetesh prodhimi: mjetet per pune dhe objekti i punes. Ne mjete per pune ai i do'lon "perveç veglave qe e bajne te mundshme veprimin e punes mbi objektin e punes" dhe "te gjitha kushtet objektive", te cilet jane te nevojshme per kryemjen e procesit te punes" kur ky (proces i punes) te merret me nji kuptim te gjane. (Theksor B. K.). "Marksi thote: "Mjeti i pergjithshem per punen e ketij lloji, prap se prap asht vetem toka, sepse ajo i jep katundarit bazen ne te cilen ai qendron, e procesit te tij i jep fushen e veprimtaris". Diçka ma pare se kjo Marksi thote: "ne mes te vet mjeteve per pune, mjetet mekanike te cilat te gjitha se bashku mund t'i quejme skelet dhe sistem muskulativ te prodhimit, na japin nji karakteristike shum ma vendimtare per karakterin e nji fare epoke te produkcjonit shoqnuer se sa mjetet vetem per mbajtjen e objektit te punes..." (Kapital, libri i pare, kaptina e V).

Ne qofte se te gjitha keto legjitimitete, qe i analizon Karl Marksi, i aplikojme ne menyren konkrete te prodhimit t'imte mallnash siç asht ekonomija katundare, mundemi me konstatue se per prodhimin e imte mallnash, siç e realizon ekonomija katundare, ne rend te pare jane karakteristike mjetet mekanike te pa-zhvilluem per pune, e vetem ne radhen e dyte çashtja, ne se katundari punues asht arendatore apo pronare ne pjesen e tokes, deri sa asht tue punue me mjete primitive teknike.

Prandaj per procesin e rekonstruimit socjalist te bujqesis, ne kushtet t'ona, tash per tash, ne rend te pare jane me randesi tri çashtje:

Çashtja e pare:

A thue do te jemi t'afte me i dhane katundarit t'one punues vegla moderne bujqesore, traktora, kombajna etj. ne sasi te mjaftueshme, me ndihmen e plote te shtetit socjalist, per llogari t'akumulimit t'one socjalist, te cilat vegla do t'ia lehtesojne punen, do te shtojne produktivitetin e punes, do te bajne te mundeshme shtimin e teprica ve dhe ekskluzivisht si te kefilla, pa kurfare detyrimi, njikohesisht me i kerkue format e ndryshme te punes kryekput vullnetare, shoqnore kooperativiste bujqesore?

Mandej, a thue ekzistojne kushtet qe ne kete fare baze te zhvillohet dhe te zgjanohet ne kuadrin e kooperatives bujqesore, prona thjeshte kooperative mbi mjetet moderne te prodhimit mbi token, qe asht konfiskue nga kapitalistat spekulanta dhe te cilen shteti na jep kooperativave, mbi podrumet, magazinat, shtepit kooperative etj. ne se, d.m.th. a mund te bahet kjo pasuni shoqnore, me rolin e plote ekonomiko-regulator te shtetit socjalist, e afte per reprodukcjonin e vete te zgjanuem, ne te cilin, diferencat e tashme te pasunis ne mes te katundarve punuesa, nuk lujne ma kurrfare roli, ne te cilen akumulimi shkon ne fondin kooperativ, e ma vone, ne baze te shtimit te produktivitetit te punes, me pjesen perkatese dhe ne fondin e pergjithshem shtetnuer t'akumulimit?

Me fjale tjera shtrohet çashtja ne se do te jemi te afte qe t'i zbatojme ne veper parimet e posht shenueme te Stalinit mbi format e reja t'aleances puntoro-katundare:

"Kjo do te thote, ne rend te pare se, perveç formave te vjetra t'aleanceme mes te katundit dhe te qytetit, kur industrija i plotsonte ma se shumti nevojat personale te katundarve (basma, kepuce, manifakture ne pergjithsi etj.) nevojiten edhe forma te te reja t'aleances, kur industrija do t'i plotsoje edhe nevojat e produkcjonit t'ekonomis katundare (maqinat bujqesore traktorat, fara e zgjedhun, plehu artificjal etj.). Derisa ma pare i plotsojshim kryesisht nevojat personale te katundarit, tue i prekë dobet nevojat produktive t'ekonomis se tij, tash na duhet, tue i plotsue edhe kendej e tutje nevojat personale te katundarit, me u perpjekë me te gjitha fuqite per furnizimin e tij me maqina bujqesore, traktora, pleh etj.; çka ne menyren ma indirekte i perket rekonstruimit te prodhimit bujqesor ne bazen e re teknike". (Mbi shmangjen ne te djathte ne PK (b) te BRSS, çashtje te Lenjinizmit, faqe 246).

Mandej, asht fjala ne se na i zbatojme apo se a do te jemi ne gjendje me i zbatue ne t'ardheshmen edhe ma forte parimet e Leninit per ndihmen financjare kooperativizmit: "çdo sistem shoqnuer krijohet vetem me anen e ndihmes financjare te klases se caktueme. As nuk duhet t'i permendi ata qina e qinda miljona rubla sa ka kostue lindja e kapitalizmit" te lire. "Tash duhet t'a kuptojme dhe t'a vendrojme ne veper kete te vertete, se sot sistemi kooperativ asht ai sistem shoqnuer, te cilin duhet t'a perkrahim me anen e mases se zakonshme. E na duhet me e perkrahe me plot kuptimin e fjales, d.m.th. ne kete perkrahje nuk mjafton me e nenkuptue perkrahjen e çfardo shitblemje kooperative, por ne kete perkrahje duhet me e kuptue ndihmen e asaje fare shit-blemjeje kooperative, ne te cilen, ne realitet, marrin pjese masat reale te populisis". (Lenini, Socinenija, XXVII 392).

Çashtja e dyte:

A thue katundari punues do t'a pranoje ndihmen e keille, nga ana e shtetit te vete, nga ana shtetit te popullit puntor?

Çashtja e trete:

A thue asht sigurue roli shtetnuer i rregullimit ne treg?

Çashtjes se pare i pergjegjet Plani i jone pesvjeçar, çashtjes se dyte i pergjegjet vet katundari i jone i vorfen dhe i mesem, vetem-sepse si asht mundue mjafte me tekniken e ulte dhe primitive ne kulm, e mundohet edhe sot, edhe sepse ka shum kupim perparimtar si per masat agroteknike ashtu dhe per veglat moderne bujqesore. Çashtjes se trete i pergjegjet vete praktika e jone dhe te gjitha dekretet t'ona te deritashme.

Shoke, ketu qendron substanca e çashtjes e jo ne te shtimit mend formal-t mbi nacjonalizimin e tokes.

Natyrisht, edhe na e dime se prodhimi i imte mallnash linde per çdo dite marredhanje kapitaliste dhe e dime se ne proçeset e ketilla, prona mbi toke mundet me luejte rol me randesi edhe rol te damshem, mbasi egzistojne mundesit qe elementat kapitalista te blejne toke, t'a rrembejne nga katundari i vorfen dhe i mesem. Por per shkak se i dime te gjitha keto, se e dime shum mire edhe pa kritikuesit, te cilet „po e gjejne Ameriken", se pushteti i jone popullor e ka ndalue me ligje, ne menyre konseguente qysh ne fillim, qysh gjate reformes agrare ne vjetin 1945, shitimin e prones mbi toke mbi 30 hektare. Mandej, asht ndalue shit-blemja e tokes pa lejen e pushtetit popullor edhe nen 30 hektare. Ma ne fund, toka e dhanun ne baze te ligjit mbi reformen agrare, nuk mund te shitet per 20 vjete, nuk mund te jepet me qira, as te lehet peng as ne tanesi ashtu dhe as pjeserisht. Perveç kesaj ne kete vend duhet me e citue edhe kryerreshtin e dyte t'art. 14 te Statutit t'one, i cili thote: „pasunit minerale ketu pjnat minerale dhe shernese, burimet e fuqive natyrale, mjetet e komunikacjonit ferovjar dhe ajruer, postat, telefonat, telegrafet etj. jane pasuni e pergjithshme popullore". Gjithashtu duhet me permende se me ligjin mbi shpronsime, i asht dhane shtetit mundesija me e shpronsue çdo toke te nevojshme me qellim te zhvillimit t'industris s'one, komunikacjonit etj.

Ne baze te te gjitha ketyne, na kemi mbrrijte, ne pikepamjen e pengimit qe elementat kapitalista ne katund te mos pasunohen me toke si dhe ne pikepamjen e pengimit qe katundari i mesem te mos bahet, tue ble toke, spekulant kapitalist, ne praktike kryesisht ate çka ka mbrrijte dekreti mbi nacjonalizimin e tokes ne vjetin 1917, ose praktika sovjetike ne republikat baltike, ku, me thane te drejten, asht deklarue nacjonalizimi, por njikohesisht katundareve u asht dhane toka ne povedim. Shifrat mbi prodhimin e drithnave ne vjetet e ndryshem, per disa kategori ekonomiash, e vertetojne kete pune fare kjarte ne vjetin 1939, ekonominat shtepijake prej 0,01 deri ne 5 ha kane marre pjese ne prodhimin e pergjithshem me 27,2%, ekonominat me 5—10 ha: 26,82%, ekonominat mbi 10 ha me 45,98%. Ne vjetin 1945 ekonominat marrin pjese ne prodhimin e pergjithshem keshtu: ato me 0,01—5 ha me 27,1%, ekonominat me 5—10 ha me 26,75%, ekonominat mbi 10 ha me 46,15%. Ne vjetin 1946, mbas reformes agrare, asht shtue pjesemarrja e ekonomive prej 0,01 deri ne 5ha me 33,36% ,pjesemarrja e ekonomive prej 5 deri ne 10 ha mbetet ne 27,38%, e pjesemarrja e ekonomive prej ma teper se 10 hektare bjen ne 39,26%. Ne vjetin 1947 ne prodhimin e pergjithshem marrin pjese ekonominat prej 0,01—5 ha me 33,05%, prej 5-10 ha me 27,35%, mbi 10 ha me 39,60%. Ne vjetin 1948 pjesemarrja e ekonomive ne prodhimin e pergjithshem te paraparne te drithnave duket keshtu- ekonominat me 5 ha marrin pjese me 34,29%, ato me 5—10 ha me 27,87%, ato me ma shum se 10 ha me 37,84%.

Nuk ka pase pra, mbas reformes agrare kurrfare kalimi me randesi te tokes. Nuk rritet, pra, perqindja e pjesemarrjes se kulakve ne prodhimin e pergjithshem dhe as nuk kthehet ekonomija e mesme katundare, e marrun ne tanesi, ne nji ekonomi kapitaliste.

Reforma agrare, siç asht zbatue ne Vendin t'one, ne te vertete nuk don me thane realizimin i kerkeses borgjeze demokratike, per nacjonalizimin e tokes por kjo, ne nji pjesse, do te thote edhe ma shum, do te thote nji mase ekonomike me karakter socjalist. Ma se gjysa ase 52,73%, nga i tane fondi agrar, ka kalue ne sektorin shtetnuer ase u asht dhane kooperativave bujqesore te punes, e ma pak se gjysa, d.m.th. 47,27% u asht dhane bujqve dhe kolonistave.

Nga te gjitha keto, shofim se akuzat ne lidhje me nacjonalizimin e tokes rrjedhin nga i njejti burim, si dhe shembujt e tjere te mekanizimit, qe kemi permende ma nalt-nga te metat e aplikimit djalektik te shkences se markshem-lenjinizmit ne gjendjen konkrete te Jugosllavis.

Transmetimi mekanik dhe jo-kritik i eksperiencave nga kushtet e tjera historike shkakton, pra, zakonisht gabime te randa, e do te mund te shkaktonte edhe rrjedhime shum te randa per zhvillimin e revolucjonit t'one. E njajta gja p.sh. asht edhe me krahasimin mekanik te RFPJ-s me vendet e tjera te demokracis popullore. Natyrisht, na nuk mund te pajtohemi qe, mbasi rrithmi i zhvillimit t'ekonomies socjaliste ne vendin t'one asht ma i shpejte se ne disa vende te demokracis popullore, te na quejne aventurista, sikurse nuk mendojme se te gjitha ato forma, te cilat jane tregue ke na si absolutisht te suksesshme e pozitive dhe te cilat i mprojme para sulmeve te pajustifikueshme, te padokumentueme deri tash dhe pa kurrfare argumentesh markiste-jane t'aplikueshme ne te gjitha kushtet dhe ne te gjitha demokracit popullore.

Ne mes t'one dhe te demokracive tjera popullore egziston nji difference esenciale. Shkurt, kjo diference perbahet nga fakti se, te gjitha ato proçese revolucjonare, jane krye ne Vendin t'one ne çlirimin definitiv dhe me çlirimin direkt te mbas luftes, ke ato kane fillue vetem mbas çlirimit. Natyrisht, ky fakt asht reflektue gjithashtu ne pikpamjen e rrithmit, formes, e per nji kohe edhe te karakterit te zhvillimit ekonomik.

Tue marre para sysh kushtet e zhvillimit ekonomik, na dallohemi hoekresisht, e ne rend te pare per sa vijon:

a) Per shkak se pushteti popullor ne Vendin t'one ka lind dhe ka fitue plotesisht e ne tanesi ne luften çlirimtare, te cilen e ka fillue dhe e ka udheheqe PKJ, e per shkak se ke ata pushteti popullor ka fillue me u-rrite dhe me u-kristalizue vetem mbas çlirimit.

Ne pikepamjen ekonomiko-shoqnore kjo diference asht çaqe ashtu qe na kemi mundje mjafte shpejte me kalue ne ndertimin e ekonomikes socjaliste, mbasi e kemi pase pushtetin popullor te konsoliduem ne baza revolucjonare, ndersa partiat Komuniste ne vendet tjera te demokracis popullore asht dashte, ne rend te pare, te merren me çashtjen e pushtetit. Natyrisht, ne krahasim me ne, kjo pune i ka vonue shum ke ata masat ekonomike me karakter socjalist.

b) Per shkak se Fronti i jone popullor i organizuem dhe i udhehequn nga PKJ, qysh gjate luftes çlirimtare, ne substance e ka marre karakterin e organizates kompakte te popullit punues, per shkak se mbas çlirimit po dallohet edhe ma teper, kurse frontet popullore ne demokracinat tjera popullore permbajne ende edhe sot elementa te forte koalicjoni dhe prandaj çfaqin gjithashtu interesat e industrijalve, tregtarve, kulakve, etj.

Ne pikpamjen ekonomike-shoqnore kjo asht reflektue n'ate menyre, qe neve na ka perkrah Fronti popullor ne zbatimin e masave ekonomike me karakter socjalist, ndersa kjo nuk ka qene gjithmone e ne tanesi ne demokracinat tjera popullore.

c) Per shkak se na kemi mundje, tue marre parasyshe faktet e permendura ma nalte, me kalue shum shpejte, energjikisht dhe sistematikisht ne likuidimin e mbeturinave te fundit t'aparatit vjeter shtetnuer dhe n'organizimin sistematik t'aparatit shtetnuer socjalist si per kah permbajtja ashtu edhe kah forma, si ne sektorin e tij administrativ ashtu edhe ne sektorin e tij ekonomik, kurse ai proçes, ke demokracinat tjera popullore, prap per shkak te fakteve te permenduna, ka marre nji rrithem ma te ngadalshem per spastrimin e aparatit te vjeter shtetnuer.

Ne pikepamjen ekonomiko-shoqnore kjo diference asht reflektue ashtu qe masat t'ona ekonomike kundra pozitave kapitaliste kane marre shum shpejte karakterin dhe tipin thjeshte socjalist, kurse ne vendet tjera te demokracis popullore ky proçes asht ma i ngadalshem.

Mandej shoku Boris Kidriç ka fole mbi tri perjudha te zhvillimit t'ekonomies socjaliste ne RFPJ.

Ofensiva dhe rritja e sektorit socjalist ose e kunderta

Ofensiva dhe rritja e sektorit socjalist ose e kunderta.

Kesaj çashtjeje i pergjigjet fare kjarte gjithshka kemi thane deri tash. Veçanerisht, flasin fare kjarte te gjitha shifrat qe i vuna ne dukje.

Prap se prap ka ngja qe te na akuzojne se ne Vendin t'one asht nji gjendje e kundert nga ajo qe e rrito i. Prandaj due te mirem me kete çashtje edhe pak ma hollesisht.

Ne rend te pare duhet me vue ne dukje se menyra, ne te cilen (kritikuesat) ia mveshin Partis s'one forcimin e elementave kapitalist, nuk vuen nga begatshmenija dhe thellesija theorike. Sikurse te mos egzistojne fare konstatimet klasike te poshte shenueme te Stalinit mbi ashpersimin e luftes se klasave: „Gabimi i dyte i Buharinit, qe rrjedh nga gabimi i tij i pare, perbahet nga shtruemja e padrejte dhe jo-markside e çashtjes s'ashpersimit te luftes se klases, forcimit te sulmit t'elementave kapitalist kundra politikes socjaliste te pushtetit sovjetik. Mbi se bahet fjale ketu? A mos asht fjala se elementat kapitalist rriten ma shpejte se sa sektori socjalist i ekonomis s'one, e se per ket shkak e perforcojne rrezistencen e vet, tue e minue ndertimin socjalist? Jo, nuk asht fjala ketu. E perveç kesaj nuk asht e vertete se gjoja elementat kapitalista rriten ma shpejte se sa sektori socjalist. Sikur t'ishte kjo e vertete atehere ndertimi socjalist do t'ishte ne pragun e germines. Ketu asht fjala se socjalizmi ban ofensive te suksesshme kundra elementave kapitalista, se socjalizmi rritet ma shpejte se sa elementat kapitalista, se per kete shkak elementave kapitalista u rezohet randesija relative, e bash per arsye se elementave kapitalista u rezohet randesija relative, elementat kapitalista e ndiejne rrezikun per vdekje dhe e perforcojne rezistimin e vet. Ata, tash per tash, kane ende mundesi me e shtue rezistimin e tyne, jo vetem per shkak se kapitalizmi botnuer iu jepe perkrahje, por edhe per shkak se, pa marre parasysh rezimin e randesis relative te tyne, pa marre parasysh kufizimin e rritjes se tyne relative ne krahasim me rritjen e socjalizmit, prap se prap del si rrjedhim rritja absolute e elementave kapitalista dhe kjo iu jep nji fare mundesije me i permbledhe fuqite per t'i ba rezistence rritjes se socjalizmit. Ne kete baze edhe bahet, ne shkallen e zhvillimit te tashem, ne kushtet e tashme te relacjonit te fuqive, ashpersimi i luftes se klases dhe perforcimi i rezistences s'elementave kapitalista te qytetit dhe te katundit". (Stalin: Nga shmangeja ne te djathte ne PK (b) te BRSS Çashtje te Lenjinizmit, faqe 237).

Mandej Stalini thote: "E dyta, tue qene se elementat kapitalista nuk do te zhdukin vullnetarisht nga tribuna, ata e kundershtojne dhe do t'a kundershtojne socjalizmin, sepse shofin se po afrohen ditet e fundit t'egzistences se tyne. E ata, tash per tash, ende munden me rezistue, sepse, me gjithse u bjene randesija e tyne relative, prap se prap ata rriten apsolutisht: mikro-borgjezija e katundit dhe qytetit nxjerre nga mesi i vet, siç ka thone Lenjini, per çdo dite dhe per çdo ore kapitalista dhe kapitalista te vegjel, e keta elementa kapitalista i marrin te gjitha masat per te mprojte egzistencen e vet".

Çka del nga kjo?

Nga kjo del se „kritikuesit" asht dashte t'a precizojne akuzen kundra Partis s'one ne baze te analizes se gjithaneshme te marredhanjeve te prohimit dhe te proceseve ekonomike ne Vendin t'one, e jo me e perhape aq lehte e ne menyre vullgare. Me nji shtruemje te ketille vullgare, ata ne realitet, i mohojne Konstatimet e Stalinit qe i thekesova. Nga fjalet e Stalinit rrjedh, me te vertete, se bashke n'ofensiven socjaliste rriten gjithashtu elementat kapitalista, deri sa egzistoj prodhimi i imte mallnash, bash per shkak se egzistojne, porse socjalizmi ritet ma shpejte se sa elementat kapitalista, se bash per ket arsye elementave kapitalista u bjen randesija relative e shi per ket shkak elementat kapitalista e shtojne rezinstencen e tyne. Sikurse „Kritikuesat" t'one t'ishin sado pak ma pa-vullgar se sa jane, atehere do te detyroheshin te pakten me na akuzue se elementat kapitalista po rriten ma shpejte se sa sektori zocjalist i ekonomis s'one, se, prandaj rritet randesija relative e elementave kapitalista dhe se ne baze te kesej ndertimi socjalist ne Vendin t'one asht ne pragun e germines.

(Vashdon ne numrin 135)

Fjalim i Shokut Xhavit Nimani ne Kongresin e Peste te PKJ

Ne diskutim ne lidhje me referatet e shokeve Tito, Rankoviq e Gjilas, muer pjese edhe delegati i Kosmet'it, shoku Xhavit Nimani i cili tha se Partija e jone e ka zgjidhe çashtjen nacionale pikrisht ne baze te doktrines marksiste-leniniste, dhe se ne Republiken Federative Popullore te Jugosllavis i jane dhane te drejtat e plota te gjitha pakicave kombetare.

Mbasi paraqiti gjansisht veprimtarin e organizates se Partis ne lidhje me shqiptaret, me pjesmarrjen e shqiptarve n'aradhat partizane gjate luftes nacional-çlirimtare, shoku Nimani kaloi ne çashtjen e pozites se pakices shqiptare ne Jugosllavi. Ai vuni ne dukje rezultatet kolosale te cilat i ka mberrijte Partija e jone ne luften kundra mbrapambetjes kulturale e ekonomike te turmave shqiptare ne Kosove e Metohi, gja qe asht prove e kjarte e politikes internacionaliste te Partis Komuniste te Jugosllavis. Ndersa ne Jugosllavin e vjeter vetem 10 perqind te shqiptarve kane dijte me shkrue e me kendue e edhe keta kane qene beglere e tregtare nder qytete, e ndersa ne Jugosllavin e vjeter nuk ka pase asnji mesues e profesor shqiptar, sot ne Kosove e Metohi jane afer 600 mesues e profesora e perveç numrit te madh te shkollave fillore, ka edhe 17 progjimnaze, kater gjimnaze t'ulta, nji gjimnaz e nji shkolle normale ne gjuhen shqipe. Ndermarrja botuese gjate vjetit 1947 ka dhane ne gjuhen shqipe prej literatures marksiste 27 libra e broshura me tirashe prej 130.000 ekzemplar. Te gjitha organizatat masovike, Fronti Popullor, Komuneti Shqiptar, FAG-u, Rinija popullore e organizatat e pionerve kane fletoret e veta ne gjuhen shqipe. Deri tash jane perkthye te dy librat e shokut Tito, mandej librat e shokeve Kardel, Gjilas etj.

Te gjitha keto jane mberrijte — tha shoku Nimani — vetem ne saje te politikes se drejte te Partis s'one, te politikes se drejte te Komitetit Qendruer, i cili e ka zgjidhe çashtjen e pakicave ashtu si na meson marksizmi-leninizmi. (duartrokitje)

Tue fole mbi rezolucjen e Byros Informative, shoku Nimani tha: „Turmat e gjana shqiptare e kane pritte me keqardhje rezolucjen e Byros Informative, dhe te gjitha akuzat e bame kundra Partis s'one, popujve t'one e Komitetit t'one Qendruer ne krye me shokun Tito. Shqiptaret kane ndie se çka ka thane Enver Hoxha para disa ditesh per Titon e Jugosllavin e re. Natyrisht, ata nuk e kane pase te kjarte se per ç'arsye asht ba nji gjest i ketille ndaj Partis s'one, para te cilit skuqet populli i Shqipnis. Na u kemi spjegue atyne se kjo rjedhe para se gjithash prej PK te Shqipnis, se kete nuk e ka ba populli i Shqipnis, pse ai n'Elbasan etj. i ka ushqye femijt te cilet i kane pase lene pa buke e i ka marre nder shtepija te veta. Njerzit nga populli i Shqipnis kane qa kur kane pa tue i hjeke fotografit e Titos.

Turmave shqiptare ne RFPJ u asht e mjaft kur ndiejne se i bahen shpifje Partis s'one Komuniste, Titos e popujve te Jugosllavis. Prandej shqiptaret e kane denue me njihere kete qendrim, ata e kane denue plotsisht qendrimin e Byros Informative. Persa i perket qendrimit te Partis Komuniste dhe Qeveris se Shqipnis, populli i jone thote se jane tregue „te pandere e te pabuorrni" dhe kane te drejte kur thone keshtu, sepse ata kane pa me sy te vet se si popujt e Partija e jone Komuniste e Jugosllavis i ka ndihmue popullit dhe Partis Komuniste te Shqipnis. Ata e kane pa kete edhe gjate luftes çlirimtare kur brigadat t'ona e aktivistat t'one te Partis kane shkue ne Lume e ne vende te tjera qe t'i ndihmojshin levizjen NÇ ne Shqipni, kane ndihmue ne krijimin e organizatave te Partis e Ushtris Nacional-Çlirimtare te Shqipnis. E dyta, ata i kane pa kamjonat me drithe qe i kane shkue prej nesh Shqipnis kur ka qene inondate aty. Ata mandej kane pa se na ne Kosmet nuk kemi mjaft doktora e inxhinjera e me gjithate ne Lume e ne vende tjera te Shqipnis kane shkue inxhinjerat e doktorat t'one qe t'i ndihmojne popullit te Shqipnis. (duartrokitje)

Lajme nga Krahina

Mbi disa gabime n'interpretimin e Dekretit mbi blemjen e drithnave ne vjetin ekonomik 1948/49

Me qellim qe te shqyrtohet puna e blemjes se drithnave, te bahet shkembimi i eksperjencave te fitueme dhe te merren masa per evitimin e gabimeve te konstatueme deri tash, te h. nen me daten 2 te k.m. u-mbajte ne Prishtine nji konference, ku mueren pjese te gjithe te besuemit e seksjoneve ekonomike te keshillave popullore te rretheve dhe te qyteteve. Perveç ketyne ne konference muerren pjese: shoku Fadil Hoxha, Kryetar i Keshillit Popullor Krahinuer, i besuemi i drejtorati te tregtis shoku Sahit Zatriqi, perfaqesuesi i Ministris se tregtis dhe furnizimeve te R.P. te Serbis, etj.

Ne kete konference u-analizue puna e planit operativ te blemjes se drithnave te bardhe, mandej çeshtja e furnizimit te popullsis se qyteteve me gjana ushqimore, gjithashtu u-shtrue çashtja e organizimit te evidences operative.

Per sa i perket çashtjes se blemjes se drithnave te bardhe u konstatue se keshillat e rretheve kane ba gabime te mdhaja ne lidhje me interpretimin dhe zbatimin e drejte te dispozitave te dekretit mbi blemjen e ketyne drithnave. Ne disa rrethe nuk asht llogarite prodhimi real mesatar i drithnave, keshtu qe ngarkimet per dorzimin e tepricave te detyrueshme nuk jane ba reale; disa keshilla tjere popullore kane lane gjyse per gjyse ma pak drith per ushqimin te pjestarve te familjes se sa e parashef dekreti perkates; per ushqimin e bagtis nuk asht lane sasija e duhun. Disa prodhues jane ngarkue me ilojet drithi qe nuk i kane mbjelle fare etj. Evidenca dhe shenimi informativ rreth blemjes nuk jane ende ne nalesin e duhun.

Shoku Fadil Hoxha, tue e perfundue fjalimin e vet ne lidhje me kete pike te fundit te dites, i vuni ne dukje keto gabime dhe disa sukseme te reja ne lidhje me andrekjen e tyne. Ai theksoi se dispozitat e dekretit duhet te respektohen perpikmenisht dhe se aplikimi i ketyne dispozitave nuk duhet te bahet me hamendje. Ritmi dhe plani i blemjes duhet te realizohet ne kohen e duhun, prandaj per kete qellim duhet t'i mobilizojne te gjitha fuqit si organet e pushtetit ashtu dhe organizatat e Partis.

Ndreqja e gabimeve te deritashme si n'organizimin ashtu ne zbatimin e perpiket te dekretit asht nji detyre mjaft urgjente dhe me randesi.

Kooperativa bujqesore e punes „Nji Maj" e ka mihe miserin per te treten here

Kooperativa bujqesore e punes „Nji Maj" po e vazhdon me sukses punen ne pasunin e vet kooperativiste. Ne keto dite asht krye mihja e misrit per te treten here dhe njikohesisht asht krye korrja e te gjitha kulturave te fashta. Antaret e kooperatives jane tue e transportue drithin e korrun ne vendet e caktueme per fshimje, qe do te fillojne per se shpejti. Nga te çmuemit e prodhimit qe asht ba ne keto dite asht konstatue se kora e sivjeme asht shum ma e mire se e vjemja.

Fshimja e drithnava te bardhe asht tue marre hovin e duhun

Ne keto ditet e fundit asht tue marre hovin e duhun fshimja e drithnave te bardhe. Ne pasunin bujqesore rejonale te stacjonit model te Prishtines ka fillue fshimja para disa dive dhe do te kejhot per 7 deri 8 dite. Drejtorija e stacjonit, sivjet e ka transportue me fuqi e veta te tane sasin e drithit ne vendin e fshimjes, kurse ne vjetin e kaluem vetem per transportimin e drithit ka pague afer 40 mije dinare. Drithin e fshime ky stacjon do t'a spastroje, plehnoje dhe do t'ua shperdaje stacjoneve tjera bujqesore dhe kooperativave bujqesore te punes per fare.

Ne rrethin e Prishtines ende nuk asht organizue si duhet fshimja, per shkak se stacjoni i maqinave — traktorave i ka dergue maqinat ne teren pa u marre vesht dhe pa e koordinue punen me kooperativat. Keshtu ka ndodhe qe makinat fshine te rrijne pa pune nga disa dite.

Ndertim i shtepijave kooperative ne rrethin e Drenices

Ne rrethin e Drenices ka fillue nderimi i te gjitha shtepijave kooperative te parapame per t'u ndertue ne kete vjet; ne Serbice, Tice, Rudnik, Turiçevc, Tristenik, Dubove, Gllogove e Kline e Eperme. Themelet e ketyne shtepijave jane hape dhe tash asht tue vazhdue puna per premjen dhe pjekjen e tullave.

Gjate garave te para Kongresit jane dallue fronitat e katundeve Tice dhe Obrije e Eperme, te cilet e kane fitue flamurin kalimtar te keshillit te rrethit te Frontit popullor. Rezultate te mira jane mberrijte edhe ne keshillin e vendit Serbice. Grate dhe rinija e ketij keshilli te vendit kane dhane ne nder te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis 2.000 ore pune dhe tri mije dinare ndihme ne te holla per shtepin kooperative. F. V.

KONKURS

Per pranimin e nxaneseve ne shkollen pedagogjike t'amvisave

Drejtorati i Arsimit i Krahines Autonome te Kosove-Metohise ne Prishtine, ne marreveshje me Ministrin'e Arsimit te Serbise, hap ne Gjakove shkollen pedagogjike t'amvisave. Mesimi do te mbahet ne gjuhen serbe dhe ka me zgjate 2 vjet. Kjo shkolle ka rangun e shkolles teknike te mesme. Shkolla ka me pase internat, ne te cilin do t'ushqehen dhe do te jetojne te gjitha nxaneset. Banimi n'internat asht i detyrueshem per te gjitha nxaneset e kesaj shkolle. Mbajtja n'internat te nxaneseve prej Kosmetit asht e sigurueme, po keshtu dhe per te gjitha nxaneset nga Republikat e tjera federale, ne qofte se ato deklarojne se me te kryemit e shkolles, do te sherbejne ne Kosmet, jo ma pak se 3 vjet. Ne rast te kundert keto nxanese do te pranohen ne shkolle, ne qofte se do te kete vend, me pagese, sikurse edhe nxaneset qe pranohen ne te gjitha shkollat e mesme teknike.

Kandidatet qe deshirojne te pranohen ne vitin e pare te kesaj shkolle d.m.th. 1948-49, detyrohen qe personalisht ose me anen e postes t'i paraqesin Drejtorise se shkolles ne Gjakove nji lutje te taksueme me 10 dinare pulla e lutjes t'i paraqesin dokumentat e poshte shenueme:

1) Certifikate lindjeje ku te vertetohet se nxanesja ka krye 17 vjeçe e nuk asht ma e madhe se 22 vjeçe.

2) Diftese shkollore mbi kryemjen e klases se III-te ose te IV-te te gjimnazit, ose mbi kryemjen e klases se dyte te shkolles femnore zejtare (merren parasysh ne kete rast edhe nxaneset qe kane krye V klase te shkolles femnore teknike zejtare).

3) Çertifikate miresjelljeje — ne se kandidatja nuk vjen direkt prej ndonji shkolle.

4) Çertifikate mjeku, mbi aftesite e saj trupore dhe shpirtnore.

5) Çertifikate mbi gjendjen ekonomike te familjes. Kete çertifikate e paraqesin vetem kandidatet prej njisieve te tjera federale, te cilat ne mbarimin e shkolles nuk deshirojne te sherbejne ne Kosmet.

6) Deklaraten qe me mbarimin e shkolles kandidatet detyrohen te sherbejne ne Kosmet jo ma pak se 3 vjet. Kjo çertifikate paraqitet vetem prej kandidatevet te ardhuna prej njisieve te tjera federale.

PREJ ZYRES SE DREJTORATIT T'ARSIMIT TE K.P.K. NE PRISHTINE

LAJME SPORTIVE

Ekipa sportive „Vellaznija" e Gjakoves mike e ekipes „Polet" te Prishtines

Me 1 te ketij mueji ekipa sportive e Gjakoves me deget foot-ball, basket-ball e voli-ball luejti ndeshje miqesore me ekipen e shoqnis „Polet". Ndeshjet jane zhvillue ne menyre vllaznore dhe si i ka hije frymes se te sportive. Asht per t'u vue ne dukje gjesti fisnik dhe kujdesi i veçant jo vetem i keshillit te shoqnis „Polet" por edhe i antarve te saje, te cilet e priten deri vone mbas mes-nate ekipen „Vellaznija", qe numronte afer 25 veta, tue i shoqnue me nji here nder vende te caktueme per fjetje. Perveç kesaj, atyne u ka qene sigurue edhe ushqimi i mire e me çmime fare t'ulta ne menzen e Drejtoratit te punve te mbrendeshme. Organizimi i shkelqyeshem i fushes sportive u ka terhjeke vemendjen e te gjithe shiquesve, tue lane nji pershtypje te thelle e admirim ne publikun prezent. Rreth e perqark te fushes kane qene vendos antaret e «Poletit» te veshun me kostumet perkatse per me evitue qe, gjate pushimit, te mos futen ne fushen e lojes tifozat e fllaket dhe femijte. Te gjitha lojnat u-zhvilluen ne menyre korekte e vllaznore ne plot-kuptimin e fjales e çka ma teper asht spikat harmonija edhe mbas lojnave. Lojtaret e te dy ekipave kane qene vazhdimisht se bashku, jane defrye e kendue ashtu si i pershtatet fiskulturistit te tipit te ri te sotshem.

Ja, nji shembull karakteristik qe duhet te ndjeket prej te gjitha shoqnive fiskulturale te Kosmetit. Kjo barre u bjene kryesisht keshillave fiskulturale, te cilet duhet te kene perveç detyrave te tjera, te kultivojne nder antaret e vet dashunin, afrimin, bujarin e mik-pritjen ndaj shoqnive mike.

Lojnat perfunduen ne favor te shoqnis «Polet» me keto rezultate: Foot-ball 2 : 1; basket-ball 27 : 18; voli-ball 3 : 1.

(N. Begolli)

Lajme nga bota

Te drejtat e lundrimit ne Danub duhet t'u takojne shteteve nderdanubjane

Ne sesjonet e deritashme qe ka mbajte konferenca nderkombtare per rregullimin e regjimit te lundrimit neper Danub, delegacjonet e shteteve perendimore kane kerkue me kambe-ngulje qe konvencjonit nga vjeti 1921 mos t'i bahet kurrfare ndryshimi. Natyrisht, ato „Status-it" te lundrimit neper Danub nuk kane dashte me i ba kurrfare ndryshimi se, ne kohnat e paraluftes u ka sigurue te drejta apsolute dhe, pasojisht edhe „te drejten e fitueme" prej kah rrjedh se, si kerkesat e tyne, ashtu edhe menyra e te folunit ka qene si ultimatum.

Mbasi foli delegati i Britanis Pik, mbi disa pika, te cilat, shum pak kishin lidhje me çashtjen e shtrueme, muer fjalen shefi i delegacjonit sovjetik A. J. Vishinski, i cili foli gjane e gjate mbi shtremnimin e konvencjonit per lundrimin neper Danub, qe i kane pase ba Anglija dhe Franca, te cilat jane ruejte si prej dreqi qe Bashkimit Sovjetik te mos i ipet e drejta me hy si antare ne konventen per lundrim neper Danub, me gjithe se Bashkimi Sovjetik, disa hera ka pas kerkue me hye ne kete konvent. Natyrisht, Bashkimi Sovjetik nuk asht pranue ne kete konvencjon, per kurgja tjeter, vetem pse ka qene komunitet popujsh me te drejta te barabarta dhe sepse, ne vendin e vet, e ka çlirue njihere e pergjithmone popullin punues dhe pse po bahej shpresa dhe shtylla ma e forte e mbare klases puntore dhe popullit puntuer te botes.

Rusija cariste ka qene antare e kesaj konvente qysh prej vjeti 1856. N'ane tjeter, per gjermanin e Hitlerit u-pa e arsyeshme qe ne vjetin 1939 te pranohej ne komisjonin e Danubit, kurse per Bashkimin Sovjetik nuk paska pase vend.

Mandej shefi i delegacjonit sovjetik foli mbi proponimin Sovjetik te konventes dhe dallimin ndermjet proponimit Sovjetik dhe konventes se vjetit 1921.

„Nji nga pikat themelore te vjetit 1921 — tha mandej Vishinski ka qene privilegje qe kane gezue shtetet jo Danubjane, persa i perket lundrimit neper Danub, te cilen privilegje ngulin kambe me e ruejte, tue quejte «te drejte te fitueme». Delegacjoni i Bashkimit Sovjetik asht i mendimit se konvencjoni i vjetit 1921 asht prishe, pse ka pesue ndryshime te mdha. Perkundrazi konvencjoni i ri siguron lundrimin neper Danub ne konform me te drejtat sovrane te shteteve Danubjane. Ai e lehteson zhvillimin e marredhanjeve ekonomike kulturale dhe perforcimin e tyne, njihere ndermjet vendeve nderdanubjane, mandej edhe shteteve te tjera.

Simbas konvencjonit te 1921, lundrimi ka perfshi si Danubin, ashtu edhe deget e tij, qe jane Tisa, Morava, Drava, Marashi, Taja etj. Simbas te njejtit artikull, lundrimi do te shtrihesh edhe mbi te gjithe kanalet, qe do te ndertoheshin ma vone. Kurse nji nga pikat kryesore te proponimit Sovjetik te konvencjonit per lundrimin neper Danub qendron ne faktin se rrjeta e lundrimit neper Danub perfshin vetem lumin Danub e jo deget e kanalet e tij.

Diferenca e trete themelore ndermjet projektit t'one dhe konvencjonit te vjetit 1921 — tha Vishinski, u perket disa çashtjeve organizative. Diferenca kryesore qendron ne perbamjen e komisjoneve. Konventa e 1921 ka pase parapa pjesmarrjen e Rumanis, Britanis Madhe, Frances dhe Italis, e ma vone edhe Gjermanis. Kjo do te thote se, nga vendet nderdanubijane ka qene vetem Rumanija. Perkundrazi proponimi i yne parashef pjesmarrjen ne komisjonin e Danubit ekskluzivisht te shteteve danubiane, gja qe i pergjigjet principit qe e kemi ndjeke gjithmone.

Propozimi i delegacionit Jugosllav

Ne Konferencen Danubiane qe po mbahet ne Beograd, delegacjoni Jugosllav parashtroi propozimin me shkrim per formimin e Komitetit t pergjithshem te konferences. Ne propozim parashifet formimi i Komitetit te pergjithshem, i cili do te kete per detyre me shqyrtue projektin e konvencjonit mbi regjimin e lundrimit neper Danub, i cili projekt i asht paraqite sekretarjatit. Ne Komitetin e pergjithshem bajne pjese delegacjonet e te gjitha shteteve qe marrin pjese ne Konference. Mbledhjet e Komitetit i kryesojne, me rradhe perfaqesuesit e vendeve qe marrin pjese ne konference me plot te drejte vote, si mbas alfabetit Rus.

Mbledhjet e Komitetit te pergjithshem bahen me dyer mbylle, por delegacjonet kane te drejte me informue perfaqesuesat e shtypit te vet, mbi punen e Komitetit te pergjithshem, simbas deshires se tyne.

Rikonstruimi i qeveris Hungareze

Minister i Punve te jashtme u-emnue Llasllo Rajk.

BUDAPEST, 5 gusht.

Korespondenti i tanjugut njofton:

Me propozimin e kryetarit te qeveris, sot, asht ba rikonstruimi i qeveris Hungareze.

Mbassi Ministri i punve te jashtme Erik Mollnar ka dhane doreheqjen si minister i ri i punve te jashtme u-emnue Ministri i deritashem i punve te mbrendeshme Llasllo Rajk. Minister i punve te mbrendeshme asht emnue zavendesi i sekretarit te pergjithshem te Partis se puntoreve te Hungaris Janosh Kadar, e minister i industris asht emnue sekretari i pergjithshem i deritashem i konfederates se punes Ishtvan Kosha.

Ministrat e ri sot bane betimin.

KORIGJIM NE BOTIMIN E POSAÇEM NUMER 132

1) Ne krye artikullit (referati i shokut Millovan Gjillas) asht botue gabimisht fjala „KUMUNISTE", ne vend te „KOMUNISTE".

2) Ne faqen e katerte, shtylla e dyte, pika 3) duhet te jete keshtu: Me ba lufte sistematike kunder influences armike ne jeten kulturale, kunder prideve dhe apolitikes tue e ngritte ne nivelin ma te naltë ideologjik dhe artistik;

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor — Sipermarrja per shtyp dhe botime "Milladin Popoviq„ Prishtine.
Pajtimet ne Ilzare i pranon: Admini-strata dhe ekspedicion.